**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DELVINE**
**KRYETARI**

Nr. 379 Prot. Delvinë, më 16.02.2022

## Thirrje publike per Keshillin Vendor te Rinise

Bashkia Delvinw shpall thirrjen publike per anetaresim ne Keshillin Vendor te Rinise. Thirrja eshte e hapur per te gjithe te interesuarit dhe qe plotesojne kriteret.
Kandidati/ja duhet te jete banorw te bashkise se Delvines dhe te moshes prej 15 deri 29 vjec. Perzgjedhja mes individeve qe kane shprehur interes behet nga grupi i punes pergjegjes i ngriturprane Bashkise duke u bazuar ne kriteret dhe procedurat qe parashikon ligji.

Kandidatet perfaqesues te organizatave rinore ose per te rinjte, duhet te permbushin kriteret e meposhtme:

a) te jene perfaqesueste nje organizate rinore ose per te rinjte/ ose individe nga shoqwria civile I grupmoshes te sipercituar;
b) te mos jete i denuar;
c) te kete pervoje ne projekte, nisma dhe veprimtari rinore dhe per te rinjte;
d) te mos kete konflikt interesi per shkak te angazhimit te KVR;

Kandidatet per KVR, perfaqesues te organizatave rinore ose per te rinjte duhet te paraqesin interesin e tyre, ne adresen e emailit bashkia.delvine@hotmail.com dhe brenda afatit duke paraqitur dokumentet e meposhtme:

a) kerkese me shkrim ku te shprehe interesin dhe motivimin per aplikim;
b) jeteshkrim;
c) fotokopje te dokumenteve qe mbeshtesin shenimet e jeteshkrimit;
d) vertetim te gjendjes gjyqesore;
dh) vetedeklarim lidhur me shmangien e konfliktit te interesave;
e) referenca nga te pakten 2 bashkepunetore te meparshem;

Thirrja per kandidatet e KVR-se, hartuar e njoftuar nga Kryetari, publikohet ne faqen

zyrtare te institucionit, ne mjediset e bashkise dhe/ose ne rrjetet sociale te institucionit per nje periudhe prej 30 (tridhjete) ditesh.

Shqyrtimi i aplikimeve dhe perzgjedhja e tyre behet brenda 10 (dhjete) diteve kalendarike nga data e mbylljes se aplikimeve.

Njoftimi publikohet ne faqen zyrtare te institucionit, ne mjediset e bashkise dhe/ose ne rrjetet sociale te institucionit.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Majlinda Qilimi**

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA DELVINE